



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **dytë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **18.03.2022** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2. Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës;
2. Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2022;
3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", nr. 01-350/05-245432/21, i dt. 12.11.2021;
4. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D 2" në kuadër të Plani rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056, dt. 04.05.2015;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve;
6. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

8. Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;
9. Informatë për gjendjen me pandeminë COVID-19 në komunën e Prishtinës;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01- 48686/22, më 04.03.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

